



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 2 dhe të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L - 049, për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2021, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDRYSHIMIN E
RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01.nr. 110-
21449, i dt. 28.02.2013

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale, 01. nr. 110 - 21449, të dt. 28.02.2013.

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, ndryshimi nënkupton lirimin nga pagesa e ngarkesës vjetore për vitin 2021 për shkak të situatës së pandemisë COVID-19, për veprimtaritë ekonomike, si në vijim:

1. Ndërmarrjet e shërbimeve hoteliere;
2. Motelet.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe drejtoritë e tjera relevante.

IV.

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr. 110-21449, i dt. 28.02.2013.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-110/05-82483/21, më 12.05.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

